



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E JUNIKUT/ MUNICIPALITY OF JUNIK - OPŠTINA JUNIK

Republika e Kosovës;
Kuvendi i Komunës së Junikut;
Numër: 02/04/21,
Datë: 04.03.2021 .

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 pika d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 22 paragrafi 22.1 pika 4) të Statutit të Komunës së Junikut, Kuvendi i Komunës së Junikut në mbledhjen e tij të rregullt të mbajtur më 26.02.2021 nxjerrë:

VENDIM

- I. Për subvencionimin e të gjithë qytetarëve të Komunës së Junikut që kanë rezultu pozitiv në testin RT-PCR SARS COV-2 nga IKSHPK, në shumë prej 100.00€, ndërsa familja, për anëtarin i cili ka humbur betejën me Covid-19, të subvencionohet në shumë prej 400.00€.
- II. Të gjithë të lartëcekurit në pikën 1, të këtijë Vendimi duhet të jenë banorë rezident të Komunës së Junikut.
- III. Ky vendim vlenë nga fillimi i pandemisë, Mars 2020 e deri në përfundimin e pandemisë.
- IV. Për zbatimin e këtij vendimii kujdesën :Zyra e Kryetarit, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa .
- V. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen zyrtare të Komunës së Junikut.

Me këtë vendim njoftohen:

1. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal;
2. Kryetari i Komunës së Junikut;
3. Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale,
4. Drejtoria për Buxhet dhe Financa .
5. Arkivi i Komunës së Junikut.

Kuvendi i Komunës së Junikut

Muharrem Krasniqi

kryesues